

Thirrje për Ekspertë

“Një hapësirë kibernetike më e sigurt dhe resiliente për fëmijët dhe të rinjtë”

Qëllimi i ekspertizës	Ekspert për hartimin dhe ofrimin e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të profesionistëve në institucionet përgjegjëse për mbrojtjen dhe edukimin e fëmijëve nga abuzimi online
Zona e zbatimit të projektit	Tiranë, Durrës, Krujë, Elbasan
Data e mundshme e fillimit të ekspertizës	Djetor 2023 – Janar 2024
Lloji i kontratës	Kontratë Shërbimi

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon një ekspert/e në kuadër të zbatimit të projektit “Një hapësirë kibernetike më e sigurt dhe resiliente për fëmijët dhe të rinjtë”. Eksperti i përzgjedhur angazhohet për të hartuar dhe ofruar një cikël trajnimesh për profesionistët e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen dhe edukimin e fëmijëve nga abuzimi online.

Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA ARSIS është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupe më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrimi i aktiviteteve në zbatim të kësaj thirrje:

“Një hapësirë kibernetike më e sigurt dhe resiliente për fëmijët dhe të rinjtë” e zbatuar nga Nisma për Ndryshim Shoqëror – ARSIS synon të promovojë të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në botën digjitale duke ndërgjegjësuar aktorët publikë si dhe nxitur bashkëpunimin ndërsektorial në 4 Bashkitë, për një mjedis më të sigurt në lundrimin online.

Projekti i zbatuar në 4 Bashki: Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Krujë, zhvillohet me mbështetjen e “**SMART Balkans – Shoqëria Civile për vlera të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor**” projekt rajonal i zbatuar nga Qendra për promovimin e Shoqërisë Civile (CPCD), Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) të mbështetur financiarisht nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme (NMFA).

Kandidati/ja do të zbatohet në kohë dhe me cilësi aktiviteteve të përcaktuara në projekt. Kandidati/ja do të jetë përgjegjës/e për ofrimin e paketës së trajnimit rreth sigurisë kibernetike dhe trajtimin e rasteve

të bullizmit online, trafikimit apo formave të tjera të abuzimit duke orientuar profesionistët edhe në përmbajtjen e kuadrit ligjor, detyrave që ka çdo institucion që mbron fëmijët nga abuzimi online si dhe mekanizmeve aktivë në sistemin aktual. Grupi i profesionistëve të cilët parashikohen të jenë pjesëmarrës në trajnime janë përfaqësues të institucioneve arsimore, shërbimeve psiko-sociale, punonjës të mbrojtjes së fëmijëve, shërbim ofrues nga organizata partnere, oficerë të sigurisë në shkolla, punonjës të policisë, përfaqësues të sistemit të drejtësisë, etj.

Rolet dhe përgjegjësitë:

Eksperti/ja i/e kontraktuar pritet të:

- Zhvillojë një program për rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të cilët janë nga sektorë të ndryshëm dhe pritet të rrisin nivelin e njohurive për funksionimin e sistemit aktual në garantimin e sigurisë kibernetike
- Ofrojë trajnime mbi programin e hartuar, tek profesionistët e sektorëve të ndryshëm duke prezantuar tek ata metoda konkrete të identifikimit, prandalimit dhe referimit të rasteve të abuzimit online;
- Të prezantojë mekanizmat e nevojshëm për sigurinë e fëmijëve në hapësirën kibernetike duke e harmonizuar informacionin e ofruar me direktivat dhe rregulloret në nivel kombëtar dhe me gjerë.
- Realizojë një raport me rekomandime dhe gjetje mbi vlerësimin e realizuar nga trajnimet e zhvilluara për çdo bashki.

Eksperti/ja ka këto përgjegjësi:

- Të bashkëpunojë me ekipin e projektit për procesin e ofrimit të trajnimeve duke dakordësuar për metodologjinë dhe mjetet e nevojshme për realizimin e trajnimeve;
- Paketa e trajnimit do të duhet të propozohet nga ana e ekspertit/es (më poshtë i referoheni një përmbajtjeje orientuese të temave si):
 - i. Teknologjia dixhitale, analiza e kontekstit aktual në Shqipëri;
 - ii. Njohja me kuadrin ligjor dhe institucionet përgjegjëse, rolet dhe përgjegjësitë referuar sigurisë kibernetike dhe institucioneve si AKCESK;
 - iii. Mekanizmi i trajtimit dhe referimit të rasteve të fëmijëve të identifikuar në rrezik apo të përfshirë në shfrytëzimin, abuzimin apo bullizmin online;
 - iv. Siguria e fëmijëve në internet, impakti i këtij fenomeni në shoqërinë tonë;
 - v. Të drejtat e fëmijëve dhe raste suksesi
 - vi. Njohja me platformat e raportimit të faqeve me përmbajtje të paligjshme
 - vii. Në bazë të gjetjeve të vlerësimit të nevojave do të zhvillohen tema të tjera.
- Të përgatisë pre-test dhe post-test për gjithë paketën e trajnimit
- Eksperti për rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të angazhohet për ofrimin e një pakete trajnimi 8 ditore (dy ditë trajnimi për ccdo bashki) duke konsideruar edhe dy ditë për përgatitjen e metodologjisë, guidës së trajnimit dhe raportit përfundimtar për organizimin e trajnimit (seancat e trajnimit do të ofrohen deri në fund të muajit janar 2024).
- Të hartojë një raport përfundimtar për të gjithë ecurinë e trajnimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të profesionistëve.

Partnerët dhe bashkëpunëtorët e projektit do të kontribuojnë në hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit sipas përkatësisë së tyre dhe përvojës.

Kualifikimet dhe eksperiencat

- Diplomë universitare në shkenca informatike, kompjuterike apo sociale;
- Eksperienca të mëparshme në organizata partnere të shoqërisë civile ose angazhime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, sigurisë kibernetike (preferohet);
- Të zotërojë aftësi dhe njohuri në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe të mësuarit digjital;
- Të njohë dhe ofrojë trajnime mbi përdorimin e teknologjisë dhe internetit të sigurt, të drejtat e fëmijëve;
- Të jetë njohës/e shumë i/e mirë e paketës ligjore për politikën mbi të drejtat, mbrojtjen e fëmijëve, migrimin, arsimin e kombinuar, planin e veprimit të arsimit për romët dhe egjiptianët, njohurive teknologjike, strategjinë e sigurisë kibernetike dhe e arsimit, etj;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe ndërveprimi në punën në grup, bashkëpunimin me institucionet dhe aktorët kyç;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze;
- Të ketë njohuri të mira të rritjes së fizibilitetit dhe promovimit të aktiviteteve të kryera;
- Të ketë dëshirë për tu zhvilluar profesionalisht apo të ndajë përvojën e vet profesionale.

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

Ekspteri trajnues/e do të zhvillojë detyrën e tij/saj në përputhje me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Koventën e të Drejtave të Fëmijëve të nënshkruar nga NISMA ARSIS.

Procedura e aplikimit:

Personat e interesuar duhet të dergojnë së bashku me kërkesën për aplikim në email:

- një kopje të jetëshkrimit profesional (CV)
- një letër interesi
- ofertë financiare

brenda datës 27 Nëntor 2023 në initiative.arsis@gmail.com, deri në mesnatë.

Përzgjedhja e ekspertit do të bazohet në:

- Relevancën e aplikimit me kërkesat e përcaktuara në Termet e Referencës.
- Përvojën përkatëse
- Ofertën financiare
- Regjistrimin tatimor (I preferueshëm)

Ju lutemi, në vemendjen tuaj që:

- në subjekt të emailit ku dërgohet aplikimi të vendoset: **Aplikim për pozicionin trajnues për profesionistët për mbrojtjen dhe edukimin e fëmijëve - Smart Balkans**
- vetëm personat e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.